




REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. 2-D/DPK	Br. Prot. 01-1354/14
Dep.	Prot No.
Nr. I faq.	Data
Broj stranica 03	Datum 16.04.2014
Nr. pages	Date
	PRISHTINË



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11) të Rregullores nr.02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 14.04.2014, nxjerr këtë :

V E N D I M

I. Mbyllët rasti me nr. AKK- 03-17/14, për znj. Drita Kadriu, Këshilltare politike në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, në ushtrim të funksionit Publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas informatës së marrë, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokollit AKK-03-0317/14 që për trajtim ka pasur znj. Drita Kadriu, Këshilltare politik, në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, ku është dyshuar për konflikt të mundshëm të interesit në ushtrimin e Funksionit Publik si, Këshilltare politike, e Ministrisë të Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe angazhimit të saj si anëtare e këshillit Drejtues të përkohshëm të Universitetit të Pejës, dhe angazhimit të saj si bashkëpunëtoresh në një OJQ,(QASHC).

Në këtë rast pala se pari është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të Interesit në ushtrim të funksionit publik.

Pas pranimit të shkresës zyrtare të AKK-së, zyrtarja e lartë ka komunikuar me zyrtarët e Agjencisë dhe ka shprehur interesin për të takuar dhe për të diskutuar çështjen e ngritur.

Në këtë fazë zyrtarët e AKK-së sipas procedurave kanë mbajtur takimin me znj. Drita Kadriu, ku dhe i kanë shpjeguar lidhur me çështjen e ngritur si dhe me informatat që posedon Agjencia kundër Korrupsionit.

Zyrtarja e lartë gjatë takimit ka treguar bashkëpunim dhe është përgjigjur në pyetjet lidhur me angazhimet e saj detyësorë që dyshohet që të jenë në mos pajtueshmëri në ushtrim të funksionit publik.

Znj. Kadriu, pas pyetjeve që i janë bërë ka theksuar se vazhdon të ushtroj funksionin e Këshilltares politike, të Ministrit të Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe është emëruar nga Ministria si anëtare e këshillit themelues të përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës, pasi që Ministri e ka emëruar në këtë funksion të përkohshëm, sikur që ka qenë e angazhuar edhe në këshillin drejtues të përkohshëm për themelimin e Universitetit të Pejës, duke pasur parasysh përvojën dhe funksionin tim si këshilltare e ministrit, dhe angazhimin tim që kam në këtë ministri që është bartëse e këtyre projekteve që rrjedhin nga vendimi i qeverisë i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, për themelimin e universiteteve të reja të Pejës, Mitrovicës, Gjakovës, dhe Gjilanit.

Zyrtarja e lartë ka theksuar se pagesat e mëditjeve për angazhimin shtesë që i janë bërë janë mbështetur nga Udhëzimi Administrativ 12/2007, dhe rregulloren 34/2012, dhe kanë vlerën e shumës prej 150 euro, në muaj.

Ndërsa sa i përket angazhimit në OJQ(QASHC), zyrtarja ka theksuar se ka qenë e angazhuar mirë por me nuk vazhdon të jetë e angazhuar pasi që është e ngarkuar me punët tjera.

Pas analizimit të gjendjes faktike dhe provave që ka në dispozicion AKK-ë, kemi ardhur në përfundim se: nuk ka të dhëna të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e gjendjes së konfliktit të interesit, dhe nuk ka mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, pasi që znj. Drita Kadriu, si zyrtare e lartë sipas funksionit që ka në këtë institucion është e angazhuar si detyrë shtesë, dhe në funksion të përkohshëm, pasi që ka të bëjë me themelimin e Universitetit të Mitrovicës, po ashtu edhe nëni 15 pika 3 e ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, e ka precizuar se: (zyrtari i lartë në cilësinë e anëtarit të organeve drejtuese dhe mbikëqyrës i personave juridik jo fitimprurës dhe personave juridik tjerë të cilat kryejnë punë nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimtarive humanitare, por nuk ka të drejtë të pranimit të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve tjera të nevojshme, për veç nëse nuk parashihet ndryshe me ligje tjera).

Nga këto që u than me lartë dëshmon se nuk kemi gjendje me elemente të konfliktit të Interesit dhe nuk kemi situatë që dëshmon se ka shkelje të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, por zyrtarja e lartë është e obliguar që të zbatoj edhe nëni 15 pika 3 e ligjit Nr.04/L-05, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, dhe nënin 13 të po këtij ligji lidhur me Deklarimin rast për raste të interesave private të zyrtarit të lartë.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

